

VENDIM
Nr. 356, datë 5.6.2024

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 212, DATË 11.3.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR
FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2013, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2.4, të vendimit nr. 212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2.5, me këtë përmbajtje:

“2.5 Përdorimi i fondit, i miratuar në buxhetin e vitit 2024, të jetë në masën 29 182 978, 59 (njëzet e nëntë milionë e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë presje pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, nga të cilat:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 480 620,59 (katërqind e tetëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet presje pesëdhjetë e nëntë) lekësh pa TVSH;

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi prej 28 702 358 (njëzet e tetë milionë e shtatëqind e dy mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë) lekësh pa TVSH në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku